

VITI SHKOLLOR 2022 - 2023

RREGULLORE E BRENDSHME E FUNKSIONIMIT TË

GJYMNAZIT TË 1^{-rë} MANDRA



Globalizimi dhe multikulturalizmi që drejtojnë realitetin social modern janë faktorë të zhvillimit të vazhdueshëm dhe ndryshimeve të rëndësishme në të gjithë sektorët. Shkolla e shekullit të 21^{-të} ftohet t'i përgjigjet në mënyrë adekuate ndryshimeve ekzistuese dhe t'u përshtatet sfidave dhe kërkesave moderne, për të kryer me sukses misionin e saj.

Është e pranuar nga të gjithë se arsimi është “guri i themelit” për mirëqenien e qytetarëve dhe të shoqërisë në përgjithësi. Qëllimi kryesor i tij nuk është vetëm transmetimi i njohurive, por edhe kultivimi mendor, shpirtëror dhe moral i nxënësve.

Në këtë kontekst, **vizioni** i përbashkët i anëtarëve të komunitetit të Shkollës sonë është:

- Ndjenja se të gjithë janë të mirëpritur dhe të sigurt në Shkollë.
- Arritja e rezultateve mësimore më të mira dhe pritshmërive të larta për të gjithë nxënësit dhe secilin veç e veç.
- Krijimi i një mjedisi shkollor mbështetës, i cili udhëhiqet nga parimet e meritokracisë, drejtësisë, mirëkuptimit, fleksibilitetit. Të jemi të lirë nga stereotipat dhe idetë e vjetruara, për të rrënjosur te nxënësit vlera si respekti për të drejtat e njeriut, drejtësia, solidariteti, vullnetarizmi, pranimi i diversitetit dhe konsolidimi i politikës demokratike.
- Formimi brenda njësisë shkollore i një klime demokratike, ku promovohet ndërveprimi, bashkëpunimi, dialogu konstruktiv dhe shkëmbimi i mendimeve ndërmjet të gjithë anëtarëve të saj.
- Ndërtimi i një klime të përshtatshme mësimore, e cila, duke marrë parasysh veçantitë dhe veçoritë e çdo nxënësi, nxit vetë-aktivitetin, favorizon zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të tij, në mënyrë që ai/ajo të përshtatet me jetën shoqërore dhe ta përcaktoj atë. Gjithashtu, për të nxjerrë në pah aftësitë e tij/saj, për të kultivuar mendimin kritik, imagjinatën krijuese, shpirtin bashkëpunues dhe kolektiv. Për t'i mësuar atij/asaj "si të mësojë" por edhe si t'i qaset njohurive në mënyrë eksperimentale. Për ta pajisur atë me njohuri dhe aftësi për integrimin e tij/saj të qetë në shoqërinë multikulturore dhe tregun e punës.

- Përgatitja e duhur e nxënësve tanë, që ata të bëhen njerëz me vullnet të fortë dhe mendim personal, të frymëzuar nga ndjenja e drejtësisë dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, që luftojnë kundër racizmit dhe diskriminimit, që vlerësojnë trashëgiminë e tyre kulturore pa nënvlerësuar kulturën e vendeve të tjera.

- Kultivimi i ndërgjegjes së tyre kombëtare dhe evropiane tek nxënësit, me synimin jo vetëm për të përballuar nevojat e kohës, por edhe për të qenë agjentë të përparimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Pajtueshmëria me Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit të Shkollës kontribuon në zbatimin e suksesshëm të vizionit të përbashkët dhe përkushtimin e të gjithëve ndaj qëllimeve të përbashkëta. Rregullorja e Brendshme e Funkcionimit të Gjymnazit të 1^{-rë} të Mandrës është e harmonizuar me Legjislacionin Arsimor Grek të dhe përbëhet nga dispozita logjike dhe të zbatueshme. Ai përcakton gjithashtu të drejtat dhe detyrimet e arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve të nxënësve. Ai bashkëformohet, bashkëvendoset dhe zbatohet nga të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës. Vlefshmëria e tij zgjat deri në datën që Këshilli i Shkollës mbledhet në mbledhjen e 1^{-rë} të çdo viti shkollor, kohë në të cilën ai përditësohet. Përveç kësaj, Rregullorja e Brendshme e Funkcionimit të Gjymnazit të 1^{-rë} të Mandras mund të përditësohet në çdo kohë tjetër që konsiderohet e nevojshme.

Për vitin shkollor 2022 - 2023, Rregullorja e Brendshme e Funkcionimit të Gjymnazit të 1^{-rë} të Mandras do të përditësohet si më poshtë.

FUNKSIONIMI SHKOLLOR

A. Detyrimet e arsimtarëve ndaj nxënësve

Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet arsimtarëve dhe nxënësve janë veçanërisht të rëndësishëm, pasi mund të ndikojnë pozitivisht në pjesëmarrjen dhe ndërveprimin e tyre brenda shkollës. Për këto arsye:

- Nxënësit i trajtojmë me dashamirësi, mirëkuptim, meritokraci, drejtësi, barazi, pa dallim gjinie, kombësie, bindjesh fetare, prejardhje sociale - ekonomike - kulturore.

- Respektojmë personalitetin si dhe mendimet e nxënësve tanë.

- Bashkëpunojmë ngushtë me mjedisin familjar të nxënësve tanë, për të përballuar të gjitha problemet që vështirësojnë studimin e tyre si dhe performancën e tyre në shkollë.

- Frymëzojmë, inkurajojmë dhe bindim nxënësit tanë që të vendosin qëllime dhe të përpiqen për arritjen e tyre.

- Përforcojmë pjesëmarrjen aktive të nxënësve tanë në të gjitha aktivitetet e shkollës.

- Sensibilizojmë nxënësit tanë, përmes veprimeve dhe fjalimeve, për çështje që lidhen me mjedisin, artin, kulturën, vullnetarizmin, qytetarinë aktive.

- Krijojmë një mjedis të sigurt shkollor, në të cilin të gjithë nxënësit inkurajohen të flasin për përvojat e tyre, shqetësimet dhe temat që i interesojnë.

- Problemet e disiplinës dhe të gjitha llojet e vështirësive, që lindin shpesh në mjedisin shkollor, ne i trajtojmë me ndjeshmëri, qetësi dhe dialog, në dobi të çdo nxënësi dhe për funksionimin e rregullt e efikas të shkollës.

B. Detyrimet e nxënësve

1. Sjellje - Disiplinë

- Respektojmë të drejtën e bashkënxënësve për të mësuar si dhe të drejtën e arsimtarëve tanë për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive.
- Trajtojmë të gjithë me respekt dhe dashuri. Respektojmë veten para së gjithash.
- Zgjidhim mosmarrëveshjet tona përmes konsultimit dhe dialogut. Nuk pranojmë ushtrimin e dhunës fizike apo psikologjike nga individë apo grupe ndaj ndonjë prej bashkënxënësve tanë.
- Respektojmë sendet personale të bashkënxënësve tanë.
- Besojmë arsimtarët tanë. Flasim me ta për çdo çështje që na shqetëson apo na bezdis.
- Jemi të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm në lidhje me komunikimin që kemi me bashkënxënësit përmes aplikacioneve të rrjeteve sociale. Ne mbrojmë të dhënat personale të të gjithëve.
- Kontribuojmë aktivisht në mbarëvajtjen e Shkollës dhe nuk e pengojmë në asnjë mënyrë.
- Takohemi rregullisht, diskutojmë dhe vendosim së bashku. Nuk kemi turp apo frikë të shprehim mendimin tonë.
- Postojmë, me miratimin e drejtorit, në tabelën e shpalljeve të shkollës njoftimet e Këshillit Pesëmbëdhjetë Anëtarësh dhe Këshillit Pesëanëtarësh të Nxënësve.
- Komunikojmë me çdo mjet të përshtatshëm, me shkrim dhe të numëruar, drejtuar Drejtorisë dhe Arsimtarëve të Shkollës, Komitetit të Unifikuar Shkollor të Arsimit të Mesëm të Bashkisë Mandra - Eidyllias dhe Shoqatës së Prindërve dhe Kujdestarëve të nxënësve të Gjinnazit të 1^{-rë} të Mandras çështjet që na shqetësojnë.
- Kërkojmë t'i zgjidhim problemet tona përmes dialogut dhe shkëmbimit të mendimeve në kuadër të Organeve Kolektive dhe respektojmë vendimet e tyre.

- Tregojmë respekt për të gjithë stafin e shkollës, arsimtarët dhe personelin tjetër (pastrueset e shkollës, rojet e shkollës, shitësen e kantinës) dhe pranojmë me mirësjellje sugjerimet e tyre.

- Përdorim gjithmonë gjuhë të mirë dhe nuk shfaqim sjellje agresive.

- Marrim pjesë aktive në të gjitha eventet e organizuara nga Shkolla, ekskursionet, aksionet, programet, aktivitetet.

- Respektojmë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të Shkollës.

- Duke ditur efektet e këqija që ka në shëndetin tonë, ne nuk pimë duhan në ambientet e shkollës si dhe gjatë çdo aktiviteti tjetër shkollor.

- Duke treguar respekt për Ligjin e Ministrisë së Arsimit dhe Besimeve Fetare, ne nuk përdorim celularin tonë ose asnjë pajisje tjetër elektronike të prodhimit audio dhe video në ambientet e Shkollës.

- Kur ka nevojë dhe dëshirojmë të kontaktojmë familjen tonë, përdorim telefonin e shkollës.

- Territorin e Shkollës, ne konsumojmë ushqime që ose i sjellim nga shtëpia ose shiten nga kantina e shkollës, duke mbështetur funksionimin e saj.

- Qëndrojmë në territorin e Shkollës gjatë gjithë funksionimit të saj.

2. Frekuentimi në Shkollë

- Mbërrijmë në shkollë në orën **8:10**. Ata që vijnë në shkollë me makinën e prindërve, **duhet të zbresim në kthesën para malores së Shkollës**, për të shmangur grumbullimit të madhë dhe ndonjë aksidenti.

- Vijnë në shkollë të pastër dhe të rregulluar. Pamja jonë pranohet gjerësisht, përputhet me statusin e nxënësit dhe tregon respektin tonë për terrenin e Shkollës.

- Kujdesemi që çdo mëngjes të vijnë në kohë në shkollë sepse dera e oborrit mbyllet në orën 8:15.

- Marrim pjesë në mbledhjen/lutjen e mëngjesit të organizuar sipas klasave dhe informohemi për çështjet që na shqetësojnë.

3. Gjatë orës së mësimit

- Hyjmë në sallë sapo bie zilja, që do të thotë fundi i pushimit.
- Nxënësit e vonuar ndjekin mësimin, ndërkohë që regjistrohen si mungues.
- Pozicionet tona në klasë përcaktohen në bashkëpunim me mësuesin përgjegjës të klasës dhe nuk ndryshojnë.
- Nuk mungojmë pa arsye në orët e ndërmjetme të programit shkollor.
- Nuk konsumojmë ushqime, kafe dhe pije freskuese brenda sallës.
- Marrim pjesë në mësim gjithmonë të përgatitur, të fokusuar, me humor të mirë dhe dëshirë për dije.
- Shmangim ndërprerjen e mësimit pa ndonjë arsye serioze.
- Marrim pjesë në testet me shkrim dhe nuk mungojmë pa arsye në to.
- Kujdesemi dhe kushtojmë vëmendje për tekstet shkollore që shteti shpërndan falas. Për shkak se ne respektojmë mjedisin, në fund të vitit shkollor i kthejmë Shkollës atë që nuk na nevojitet, për t'u ricikluar.
- Mbajmë klasën tonë të pastër dhe me shije.
- Nuk shkruajmë në tavolina dhe mure.
- Jemi informuar për ndarjen tonë në grupet e tjera të shkollës, kur nuk kemi mësim për shkak të mungesës së jashtëzakonshme të mësuesit, sipas Aktit 12/12-09-2022 të Shoqatës së Arsimitarëve.
- Ata që kanë përjashtim nga mësimi i Edukimit Fizik dhe Fetar ndjekin një mësim tjetër në një grup tjetër të klasës së tyre në atë kohë të caktuar, sipas programit të shkollës.

4. Gjatë kohës së pushimit

- Gjatë gjithë pushimit qëndrojmë në oborrin e shkollës.
- Kur koha është me shi, ne qëndrojmë në katin përdhes të ndërtesës së shkollës dhe nuk ngjitemi lart.
- Klasat janë të mbyllura dhe dritaret e tyre të hapura për ajrim.

- Ecim në të gjitha hapësirat me qetësi dhe nuk bërtasim.
- Kujdesemi që oborri të jetë i pastër.
- Njoftojmë miqtë tanë jashtëshkollorë se Shkolla nuk është vendi ynë i takimit.
- Shmangim bisedën me njerëz që nuk janë pjesë e komunitetit tonë shkollor.
- Respektojmë udhëzimet e mësuesve në detyrë dhe u drejtohem atyre për të gjitha problemet tona.
- Nuk luajmë lojëra ekipore me topa që i kemi sjellë nga shtëpia.

5. Largimi nga Shkolla

- Largohe mi nga Shkolla **sapo të përfundojë Orari i Programit Mësimor të Klasës tonë, në orën 14:00 ose 13:20.**
- **Në raste të jashtëzakonshme**, ne mund të largohemi më herët se koha e paracaktuar **vetëm** me leje nga Drejtoria e Shkollës dhe pas konsultimit me prindërit dhe kujdestarët tanë.
- Sipas Aktit 47/23-01-2023 të Shoqatës së Mësimdhënësve, në rast të mungesës së jashtëzakonshme të mësuesit, nxënësit e klasave që kanë mësim me mësuesin konkret, ndahen çdo dy nxënës në klasa të tjera dhe ndjekin në mënyrë krijuese nën mbikqyrjen e një mësuesi dhe largohen nga Shkolla sipas kohës së paracaktuar të përfundimit të funksionimit të saj

C. Bashkëpunimi i Shkollës me prindërit dhe kujdestarët e nxënësve

Komunikimi dhe bashkëpunimi i shpeshtë dhe konstruktiv ndërmjet Drejtorisë dhe arsimtarëve të Shkollës me prindërit dhe kujdestarët e nxënësve siguron funksionimin normal të Shkollës dhe ofrimin e arsimit të synuar për nxënësit, i cili ka të bëjë si me përvetësimin e njohurive ashtu edhe dhe në kultivimin e aftësive sociale si dhe të vlerave morale.

Si prindër dhe kujdestarë të nxënësve të gjimnazit të 1^{-të} të Mandras :

- Informohemi plotësisht për frekuentimin dhe rezultatet e fëmijëve tanë.
- Kujdesemi që të informojmë Drejtorinë dhe mësuesit e Shkollës për çdo

faktor që ndikon në frekuentimin dhe rezultatet e fëmijëve tanë.

- Marrim pjesë aktiv dhe mbështesim të gjitha aktivitetet e Shkollës.

D. Bashkëpunimi i Shkollës me komunitetin lokal

Bashkëpunimi i Shkollës me organet vendore konsiderohet i domosdoshëm, sepse përmes tij është e mundur të zgjidhen probleme të ndryshme që lidhen me objektet e ndërtesës dhe infrastrukturën e saj logjistike, nga ana tjetër mund të funksionojë në mënyrë mbështetëse dhe shumëfishuese në punën e njësisë shkollore, duke promovuar përpjekjet e nxënësve dhe rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në aktivitetet e Shkollës.